



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 2362, datë 10.10.2013

Për

“Shqyrtimin e kërkesës ankimore të sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.A., paraqitur AKEP-it me shkresë datë 04/10/2013 (Ref. Vodafone: CEO/118/MF).”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- | | |
|---------------------------|----------|
| 1. Znj. Alketa Mukavelati | Kryetare |
| 2. Z. Alban Karapici | Anëtar |
| 3. Z. Benon Paloka | Anëtar |
| 4. Znj. Elkeda Domi | Anëtare |
| 5. Znj. Zamira Nurçe | Anëtare |

dhe sekretare Znj. Mirela Xhelaj, në mbledhjen e datës 10/10/2013, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 102.2012, datë 34. 10. 2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 8480, datë 27. 05. 1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

Kërkesa ankimore e sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.A., paraqitur AKEP-it me shkresë datë 04/10/2013 (Ref e tij: CEO/118/MF), “Kërkesë për rishikimin e VKD nr. 2354 datë 27. 09. 2013 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve Altelecom Sh.A., dhe Vodafone Albania Sh.A.” dhe deklarin e tij si absolutisht të pavlefshëm”.

BAZA LIGJORE

1. Shkronjat a) dhe n) e nenit 8, pika 1 e nenit 114, pikat 1 dhe 2 të nenit 115 dhe neni 120 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (***ligji nr. 9918***);
2. Neni 135 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12. 05. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (***KPrA***);

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

- Shkresë datë 04/10/2013 (Ref e tij: CEO/118/MF), “Kërkesë për rishikimin e VKD nr. 2354 datë 27. 09. 2013 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve Altelecom SH.A., dhe Vodafone Albania Sh.A.” dhe deklarimin e tij si absolutisht të pavlefshëm” (**Kërkesa ankimore**)
- Projektakti administrativ “ Për shqyrimin e kërkesës ankimore të sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.A. ”, paraqitur AKEP-it me shkresë datë 04/10/2013 (Ref. juaj CEO/118/MF”) (**Projektakti**);
- Relacioni mbi projektaktin;

duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipër cituar, akteve të nxjerra nga AKEP-i:

- Vendim nr. 2354, datë 27/09/2013 për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve Altelecom Sh.A., dhe Vodafone Albania Sh.A.,” (**VKD nr. 2354/2013**);
- Vendim nr. 2122, datë 04. 07. 2012 për “Përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.A., me Fuqi të ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese” (**VKD nr. 2122/2012**);
- Vendim nr. 2163, datë 21. 09. 2012 për “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Altelecom Sh.A., në lidhje me Aktin Administrativ, Vendim nr. 2122, datë 04. 07. 2012 të Këshillit Drejtues për “Përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.A., me Fuqi të ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese” (**VKD nr. 2163/2012**);

VËREN:

Sipërmarrësi Vodafone Albania Sh.A., me shkresë datë 04/10/2013 (Ref e tij: CEO/118/MF), “Kërkesë për rishikimin e VKD nr. 2354 datë 27. 09. 2013 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve Altelecom SH.A., dhe Vodafone Albania Sh.A.” dhe deklarimin e tij si absolutisht të pavlefshëm”, kërkon:

- **Rishikimin e menjëhershëm të VKD nr. 2354/2013;**

dhe në bazë të kompetencave që i njeh AKEP-it Kodi i Procedurave Administrative në nenin 117/2, fton **AKEP-in**:

- **Të deklarojë këtë akt administrativ si absolutisht të pavlefshëm dhe që nuk prodhon asnjë pasojë ligjore.**

Ftesa e ankimuesit për deklarinimin nga AKEP-i të VKD nr. 2354/2013 si absolutisht të pavlefshëm, duke patur parasysh kushtet ligjore të përcaktuara në shkronjat b) dhe c) të nenit 116 të KPrA bazohet në pretendimet e tij, se:

- VKD nr. 2354/2013 është një akt i nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore;
- VKD nr. 2354/2013 është një akt i nxjerrë nga një organ administrativ në kundërshtim flagrant të ligjit.

A. Pretendimin se VKD nr. 2354/2013 është një akt i nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore, ankimuesi e arsyeton duke parashtruar se:

“AKEP me anë të VKD së mëparshme 2118 datë 04. 07. 2012, ka vendosur që e drejta për akses dhe tarifa e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të tranzituara nga operatorët vendas të jetë jashtë rregullimit dhe “Aksesi dhe tarifa e terminimit për trafikun hyrës ndërkombëtar është objekt i negociatave tregtare ndërmjet palëve” duke filluar nga data 1.09.2012. Për rrjedhojë konflikti ndërmjet Altelecom Sh.A., dhe Vodafone Albania Sh.A., është një konflikt tregtar në vijim të një veprimtarie tregtare për të dy palët, e rrjedhur nga Marrëveshja ndërmjet Altelecom dhe Vodafone Albania për shërbimin e terminimit të trafikut ndërkombëtar. Në kuptim të nenit 334 të Kodit të Procedurës Civile, zgjidhja e një konflikti të tillë është vetëm kompetencë e gjykatës së shkallës së parë dhe jo e AKEP. Çdo ndërhyrje, qoftë dhe e ndërmjetme e AKEP, në një marrëdhënie të lirë tregtare mes palësh çënon parimin bazë Kushtetues të lirisë ekonomike.”

I. AKEP-i e kundërshton pretendimin e palës për tejkalim të kompetencës së tij, duke arsyetuar se:

- **akti (VKD nr. 2354/2013) është një akt i nxjerrë në përputhje të plotë me kompetencat e tij ligjore.** Kjo pasi,

1. Me depozitim të kërkesës për zgjidhje të mosmarrëveshjes administrative midis palëve, AKEP si organi i administratës publike fillimisht ka saktësuar dhe verifikuar kompetencën lëndore-funksionale /juridiksionin e tij përkatës (shih nenin 72, e vijues, K.Pr.A) nëse ka diskrecion për të vendosur për çështjen objekt i konfliktit administrativ.

2. Për të ushtruar pushtetin e tij, nëpërmjet shfaqjes së vullnetit juridik përkatës, AKEP është i pajisur nga ligji material me tagret e nxjerrjes së akteve administrative, ky ligj material (Ligji nr. 9918, i ndryshuar) dhe aktet me fuqi nënligjore të nxjerra në zbatim të tij kanë përcaktuar kompetencat e AKEP për fushën administrative që mbulon me qëllim ushtrimin e të drejtave dhe detyrave brenda juridiksionit përkatës.

Pasi AKEP e ka çmuar pozitën e tij juridike se gjendet plotësisht në kompetencën e tij administrative për të ushtruar pushtetin e tij diskrecional (të autorizuar nga K.Pr.A dhe ligji material (Ligji nr. 9918), i ndryshuar) dhe se duhet të ndërhyjë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, ka përcaktuar mënyrën dhe formën se si duhet të shfaqë vullnetin e tij administrativ dhe publik, duke e shqyrtuar plotësisht kërkesën ankimore (nismën e palës

kërkuese) dhe ka konkretizuar veprimtarinë e tij vendimmarrëse dhe ekzekutive me nxjerrjen e aktit administrativ VKD nr. 2354/2013. Kontrollin e ligjshmërisë dhe kompetencës së autoritetit të tij, AKEP në kuadër të mbrojtjes së interesit publik si dhe të mbrojtjes së interesave ligjore të personave privatë (*Albtelecom sh.a dhe Vodafone Albania sh.a.*) e perligj nën arsyetimin e drejtë se: sipërmarrësit në konflikt Albtelecom Sh.A. dhe Vodafone Albania Sh.A., janë subjekte të ligjit nr. 9918 dhe çështja në objekt shqyrtimi sipas VKD nr. 2354/2013 përbën një çështje të lidhur substancialisht me marrëdhëniet e sipërmarrësëve në fushën e komunikimeve elektronike (*akses dhe interkoneksion*) të cilat rregullohen nga ky ligj dhe aktet e nxjerra në zbatim të tij (*shihni neni 4, gërma a) n) e nenit 8 dhe dispozitën materiale neni 120 pika 1 e tij*).

Bazuar në nenin 120 më sipër cituar, AKEP si organ administrativ e ka konsideruar kompetencën e tij funksionale për pranimin e ankimit të Albtelecom, shqyrtimin e tij, dhe nxjerrjen e aktit përkatës (*VKD nr. 2354/2013*) jo vetëm si një të drejtë ligjore për të kryer veprimtarinë e tij konkrete administrative por edhe si një detyrim për të ushtruar këtë veprimtari, në të kundërt, do të cmohej në pozita jofavorizuese si një organ i cili me veprimet dhe mosveprimet e tij ka shpërdoruar diskrecionin e dhënë nga legjislati në fuqi nëpërmjet mosrespektimit të gabuar ose edhe të qëllimshëm të dispozitave normative.

3. Pra nga pikëpamja ligjore, duke qenë një çështje e lidhur me zbatimin e ligjit nr. 9918 dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, AKEP-i disponon kompetencë të plotë administrative-ligjore të sanksionuar në ligjin material nr. 9918, për shqyrtimin e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve Albtelecom Sh.A., dhe Vodafone Albania Sh.A., depozituar në AKEP nga sipërmarrësi Albtelecom Sh.A., me shkresë Nr. 5880 Prot, datë 25. 09. 2013 “*Kërkesë për zgjidhje mosmarrëveshje me Vodafone Albania*”, duke ushtruar pushtet diskrecional të plotë, për nxjerrjen e një vendimi diskret të arsyetuar (*VKD nr. 2354/2013*) dhe të perligjur në urdherimet e tij duke përcaktuar marrëdhëniet juridike dhe pasojat që ky akt krijon me përmbajtje të fillimit të rregullimit dhe zgjidhjes administrative të mosmarrëveshjes nën një hetim të plotë administrative që do të zhvillojë KZM-ja, duke ndërtuar një dispozitiv të tij me natyrë dobiprurëse për shkak se arsyetimi i këtij akti nga AKEP përveç detyrimeve krijon edhe dobi.
4. Fakti që AKEP-i, në zbatim të kompetencave të tij ligjore, të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 9918 lidhur me rregullimin e konkurrencës në treg, konkretisht dispozitat (*nenet 31 e vijues*), që normojnë marrëdhëniet lidhur me përcaktimin e tregjeve, analizën e tregut, vendosjen e masave dhe detyrimeve rregullatore, si dhe përcaktimin e sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT), me **VKD nr. 2122/2012** mbi bazën e rezultateve të analizës së kryer të tregut për sipërmarrësin Vodafone Albania Sh.A., ka vendosur:
 - mosdeklarimin e Vodafone Albania me FNT në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin telefonik publik të lëvizshëm të tij;
 - heqjen e detyrimeve të vendosura për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare sipas vendimit nr. 1211, datë 31 03.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP-it dhe amendimet e tij;

- nxjerrjen jashtë rregullimit të tarifave të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin telefonik publik të lëvizshëm të Vodafone Albania dhe vendosjen e tyre objekt të negociatave komerciale me sipërmarrësit e tjerë;

nuk përbën shkak ligjor që marrëveshjet e lidhura nga sipërmarrësi Vodafone Albania Sh.A., me sipërmarrësit e tjerë për aksesin e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, të konsiderohen si një marrëdhënie vetëm tregtare jashtë kompetencës së AKEP-it për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve midis tyre, kur sipas shkronjës n) të nenit 8 dhe nenit 120 të ligjit nr. 9918 njera nga palët në marrëveshje paraqet një kërkesë në AKEP për zgjidhje mosmarrëveshje.

Neni 120 nuk parashikon asnjë klauzolë përjashtuese në adresë të AKEP-it, për inkopetencë në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve edhe pse AKEP-i me një vendim të arsyetuar dhe të bazuar në një analizë tregu e ka deklaruar këtë sipërmarrës si sipërmarrës jo me FNT në një treg përkatës dhe për rrjedhojë këtë treg e përcakton jashtë rregullimit lidhur me vendosjen e masave dhe detyrimeve rregullatore, duke përfshirë këtu edhe rregullimin e tarifave. Është AKEP-i ai, që si organ kompetent i fushës, edhe në rastet e tregjeve të nxjerra jashtë rregullimit, në varësi të rrethanave të faktit, karakterit të mosmarrëveshjes, lidhjes së saj me zbatimin e ligjit nr. 9918 dhe akteve në zbatim të tij, interesit publik dhe funksionimit normal të rrjeteve, vlerëson nëse një kërkesë për zgjidhje mosmarrëveshje midis sipërmarrësve duhet pranuar ose jo për shqyrtim.

Marrëveshja midis dy sipërmarrësve lidhur me aksesin e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetet publike të komunikimeve elektronike në statusin e një tregu përkatës të nxjerrë nga AKEP-i si organi kompetent rregullator, jashtë rregullimit në kuptim të ligjit nr. 9918, si dhe lirisë kontraktuale për vendosjen e tarifave të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare nëpërmjet negociimit të tyre mbi bazën e respektimit të interesit komercial reciprok të palëve, pavarësisht këtij statusi, është një marrëveshje specifike që buron nga ligji nr. 9918 dhe aktet rregullatore. Si e tillë, veprimtaria që ushtrohet mbi bazën e kësaj marrëveshje në çdo rast është objekt i monitorimit nga AKEP-i dhe i nënshtrohet gjykimit të këtij organi nëse duhet ndërhyrë ose jo me masa dhe detyrime rregullatore mbi bazën e rezultateve të një analize tregu në intervale të rregullta por jo më vonë se një herë në dy vjet, sipas nenit 34 të ligjit nr. 9918. Megjithatë, ligjvënësi në nenin 51 të ligjit nr.9918, sipas rastit parashikon vendosjen e detyrimeve nga AKEP-i ndaj sipërmarrësve edhe kur këta sipërmarrës nuk kanë fuqi të ndjeshme në treg.

5. Për sa i përket interpretimit literal mbi nenin 334 të Kodit të Procedurës Civile, "**Kompetencat** (Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001, neni 126), në interpretimin tonë funksional kjo dispozite përcakton kompetencën lëndore lidhur me shqyrtimin gjyqësor nga seksionet e gjykatave, të çështjeve që lidhen me mosmarrëveshjet tregtare midis palëve dhe jo atë të përcaktimit të kompetencës së kontrollit administrativ të këtyre çështjeve nga organet kompetente administrative dhe rregullatore për shqyrtimin e tyre, kur një kontroll të tillë e parashikon ligji si në kontekstin ligjor të rastit në fjalë.

AKEP, thekson faktin se kur disa përcaktime normative konkurrojnë rregulli i aplikueshëm është parashikimi ligjor që i vjen më afër në zbatim çështjes, që e rregullon së pari atë, dhe që gjendet nën funksionalitetin e tij në fazën (*rekursin/gjendjen*) që ndodhet çështja, në këtë mënyrë përgjatë ezaurimit të rekursit administrativ (*i pashteruar ende*) palët duhet të referohen në kuadrin ligjor përkatës duke e mbështetur në mënyrë të argumentuar pretendimin e tyre, konkretisht prioritet dhe funksionalitet ka zbatimi i dispozitave të K.Pr.A-së.

B.Pretendimin se VKD nr. 2354/2013 është një akt i xjerrë nga një organ administrativ në kundërshtim me ligjin, ankimuesi e arsyeton duke parashtruar se:

“Marrja e VKD nr. 2354/2013 në mënyrë të nxituar dhe në tejkalim të kompetencave tregon qartë se vendimi është marrë në kundërshti me parimet e barazisë, proporcionalitetit, paanësisë, drejtësisë (nenet 11 dhe 12 të KPrA) dhe në kundërshti me objektivat rregullatore të AKEP-it për të garantuar barazi, mosdiskriminim dhe konkurrencë të ndershme në treg (nenet 7 dhe 8 të ligjit nr. 9918). Ky VKD favorizon haptaz, në mënyrë të njëanshme, diskriminuese dhe të pajustificuar sipërmarrësin Altelecom në kurriz të interesave tregtare legjitime të Vodafone”.

II. AKEP, e kundërshton këtë pretendim si të pabazuar dhe që nuk qëndron pasi VKD nr. 2354/2013 është një akt i nxjerrë nga një organ administrativ brenda kufijve të kompetencave të tij dhe me attribute rregullatore në impenjim maksimal për zbatim rigoroz të ligjshmërisë, duke iu referuar si rregullimeve ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9918, i ndryshuar, ashtu dhe atyre të parashikuara në KPrA, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, kjo pasi:

1. Në arsyetimin dhe dispozitivin e VKD nr. 2354/2013, AKEP-i në kuptim të nenit 11 dhe 12 të KPrA, i është përmbajtur parimit të barazisë dhe proporcionalitetit midis interesave private të palëve ashtu dhe ato publike, si dhe trajtimit në mënyrë të ndershme, të paanshme dhe të paprivilegjuar të dy subjekteve, palë në mosmarrëveshje.
2. Respektimi i parimit të barazisë dhe proporcionalitetit midis interesave private dhe atyre publike në VKD nr. 2354/2013 manifestohet nëpërmjet marrjes së një vendimi nga AKEP-i si institucion publik për zgjidhjen e një mosmarrëveshje midis dy palëve me interesa private, subjekte të ligjit nr. 9918, të cilat ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike të vlefshme për publikun, duke nisur një procedurë të rregullt ligjore për shqyrtimin e saj sipas kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi pa cënuar asnjë interes të prezumuar të tyre, të cilin e kanë përfituar bashkërisht si palë në një marrëveshje të lidhur në kushtet e lirisë së negociimit me terma komerciale mbi bazën e interesit reciprok, në kuadër të statusit të dhënë nga AKEP-i për tregun përkatës si një treg jashtë rregullimit në kuptim të ligjit nr. 9918.
3. VKD nr. 2354/2013 është nxjerrë nga AKEP-i si një akt procedural në zbatim të nenit 46 e vijues të KPrA, meqenëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjes sipas nenit 120 të ligjit nr. 9918, parashikohet zbatimi i KPrA. AKEP nëpërmjet vendimmarrjes së tij është treguar i kujdeshëm në arritjen e qëllimit të ligjshëm të tij (*zgjidhje e mundshme e afërt e mosmarrëveshjes administrative*) të përdorë mjetet më të përshatshme, të padëmshme dhe në përpjestim të drejtë me gjendjen konfliktuale të krijuar mes këtyre dy palëve në tregun e komunikimeve elektronike. Vendimi përfundimtar sipas nenit 100 të KPrA për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të merret nga AKEP-i në vijim të zbatimit të procedurës sipas neneve 80 e vijues të këtij kodi. Kjo procedurë, brenda afatit ligjor të kryerjes së saj, iu jep mundësinë palëve të parashtrorë pretendimet dhe kërkesat e tyre si dhe të paraqesin çdo provë në mbështetje të pretendimeve dhe kërkesave të parashtruara. Duke patur parasysh karakterin procedural të këtij vendimi AKEP-i në marrjen e vendimit për fillimin e procedimit administrativ nuk ka shfaqur asnjë shenjë nxitimi apo anësie, cënimi të barazisë mes palëve etj. Është vendimi përfundimtar që do të marrë organi kompetent

mbi bazën e raportit të organit që zhvillon procedurën hetimore, i cili do të përcaktojë në mënyrë të arsyetuar qëndrimin që do të mbajë AKEP-i lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe jo VKD nr. 2354/2013.

4. Urdhërimi i ndërmjetëm në përmbajtje të VKD nr. 2354/2013, për vazhdimin nga palët e marrëdhënies së ndërprerë, në termat dhe kushtet e marrëveshjes ekzistuese para nisjes së konfliktit, erdhi si rezultat i gjykimit të rrethanave të çështjes bazuar në nenin 78 të KPrA.
 - Duke çmuar rast pas rasti rrethanat e krijuara lidhur me pasojat e sjelljes së palëve në mosmarrëveshje, pasi kishin arritur deri në bllokimin e plotë nga ana e Vodafone Albania të kapaciteteve të interkoneksionit të dedikuara për terminimin e trafikut ndërkombëtar të tranzituar nga Albtelecom, si dhe duke konsideruar se nga kjo sjellje interesit publik mund t'i shkaktohen dëme të rënda dhe të pariparueshme, pasi:
 - Palët në mosmarrëveshje janë dy sipërmarrësit më me peshë në tregun e komunikimeve elektronike në vend, si në aspektin e ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike ashtu dhe në drejtim të numrit të pajtimtarëve që disponojnë në rrjetet respektive;
 - Sjellja e këtyre dy sipërmarrësve në drejtim të sigurimit të një konkurrence të lirë dhe efektive në treg është me ndjeshmëri shumë të lartë dhe thelbësore për nxitjen nga ana e AKEP-it të investimeve efikente në infrastrukturën e komunikimeve elektronike dhe zhvillimet e reja teknologjike për një cilësi të lartë të produkteve të tyre;
 - Duke çmuar gjithashtu nevojën për të vendosur me një akt të veçantë, të cilin legjislatori e ka parë të arsyeshme ta mundësojë për organet e administratës shtetërore ose enteve publike nëpërmjet instrumentit ligjor të përcaktuar në nenin 78 të KPrA, lidhur me çështje të caktuara në funksion të zgjidhjes përfundimtare;

AKEP-i vendosi masën e përkohshme të urdhërimit për vazhdimin e marrëveshjes ekzistuese, e cila kishte funksionuar në përputhje me dëshirën dhe vullnetin e lirë të palëve deri në lindjen e konfliktit, për të mos lejuar një përkeqësim të mëtejshëm të mundshëm të situatës në funksion të ruajtjes së një balance midis interesit privat të palëve dhe interesit publik, duke nxjerrë një vendim të ndërmjetëm në përbërje të dispozitivit të VKD nr. 2354/2013, deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar. Kjo masë e përkohshme nuk nënkupton asnjë insinuatë lidhur me mënyrën dhe qëndrimin që do të mbajë AKEP-i në vendimin përfundimtar për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

5. Në aspektin procedural, AKEP-i gjatë zhvillimit të procedurës hetimore deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar do të veprojë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të parashikuara në KPrA për këtë qëllim duke mbajtur parasysh në marrjen e vendimit përfundimtar, përmbushjen e objektivave rregullatore për nxitjen e konkurrencës dhe mbrojtjen e interesave të përdoruesve, sipas parashikimeve në këtë ligj.

Ankimuesi pretendon se nuk ekziston:

- asnjë lloj dëmi ndaj interesit publik çka fakton se palët nuk ndodhen në kushtet e nenit 78 të KPrA dhe marrjes së vendimit të ndërmjetëm;

- cënim i interesit publik për palët e origjinuara;
- cënim i interesit publik për pritësit e thirrjeve (pajtimtarët e Vodafone)

Por, për sa arsyetojmë më sipër dhe në VKD nr. 2354/2013, duke patur parasysh këtu edhe faktorët që janë analizuar në analizën përkatëse për tregun e aksesit të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare dhe marrjen e vendimit nga AKEP-i bazuar në këto rezultate për mos deklarimin me FNT për këtë treg, si për sipërmarrësin Vodafone Albania ashtu edhe sipërmarrësit e tjerë të cilët ofrojnë rrjete dhe shërbime publike të telefonisë në vend, si dhe të nxjerrjes jashtë rregullimit të tarifave të terminimit të këtyre thirrjeve dhe vendosjen e tyre nëpërmjet negociatave mbi bazën e lirisë kontraktuale dhe interesit reciprok komercial AKEP-i gjykon se çështja ka lidhje të ngushtë me interesin publik.

C. Në kërkesën ankimore sipërmarrësi Vodafone Albania pretendon se ankesa e Albtelecom është në kushtet e “gjësë së gjykuar” dhe si e tillë nuk duhej marrë në shqyrtim nga AKEP në VKD nr. 2354/2013. Sipas ankimesit objekti i VKD nr. 2122, datë 04. 07. 2012 të AKEP-it trajton të njejtin objekt ankimi të sipërmarrësit Albtelecom Sh.A., si atë të inicuar nga AKEP-i me VKD nr. 2354/2013.

1. Për këtë pretendim sqarojmë se AKEP-i në trajtimin e mosmarrëveshjeve midis sipërmarrësve nuk udhëhiqet vetëm nga parimet e kontrollit gjyqësor, por edhe ato të kontrollit administrativ (me prioritet në fusheveprimin administrative të AKEP) dhe çfarë është më e rëndësishmja, ato që udhëheqin dhe përcaktojnë frymën e veprimtarisë së një organi rregullator të fushës në përputhje me ligjin material nr. 9918 dhe politikën e zhvillimit sektorial të Këshillit të Ministrave.

2. Gjithësesi, AKEP garanton ankimesin dhe çdo palë të interesuar se ai vendim si dhe çdo akt i nxjerrë nga AKEP-i për këtë çështje do të merret në konsideratë në funksion të një zgjidhje të mosmarrëveshjes, të drejtë, të bazuar ligjërisht dhe në mbrojtje të interesave publike dhe ato private.

D. Në kërkesën ankimore sipërmarrësi Vodafone Albania parashtron se “AKEP-i nuk ka vendosur në dispozicion të Vodafone kërkesën/ankimin e paraqitur nga Albtelecom...”

Në zbatim të dispozitave ligjore të përcaktuara në KPrA, rregullores së AKEP për procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe praktikës së zbatuar deri më sot, AKEP-i do të vendose në dispozicion të palëve të interesuara çdo dokument që do të trajtohet në kuadër të shqyrtimit të çështjes sipas procedurës.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, i ndryshuar, dhe nenit 46 e vijues dhe nenit 146 të K.Pr.A,

VENDOS:

1. Lënien në fuqi të aktit administrativ VKD nr. 2354/2013 dhe rrëzimin e ankimit.
2. Ky vendim t'iu dërgohet palëve në mosmarrëveshje dhe të publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R E

Alketa MUKAVELATI

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Elkeda DOMI**
4. **Zamira NURÇE**